



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Letërsi e Gjuhes B (2)

Ngarkesa: 4 kredite, 20 leksione, 20 seminare
Viti / Semestri: Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: T'u japë studentëve një kuadër të gjerë teorik dhe historik mbi zhvillimin e letërsisë britanike moderne nga fundi i shekullit XIX deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Të ndërtojë një kuptim të qëndrueshëm për tri zhanret kryesore letrare: prozën, poezinë dhe dramën në periudhën moderne. Të zhvillojë aftësi analitike dhe interpretuese nëpërmjet ndërthurjes së njohurive teorike me analizën e veprave konkrete.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të aftësojë studentët për të identifikuar tiparet thelbësore të prozës, poezisë dhe dramës moderne britanike.
2. Të zhvillojë aftësinë për të analizuar tekste letrare përmes koncepteve të përvetësuara në mënyrë kronologjike e tematike.
3. T'i nxisë studentët të shkruajnë ese, recensione dhe të bëjnë prezantime, duke përdorur terminologjinë përkatëse të kritikës letrare.

Rezultatet e pritshme:

1. Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:
2. Njohin sfondin historik, kulturor dhe letrar të letërsisë moderne britanike dhe zhvillimet e saj kryesore.
3. Kryejnë analiza letrare të veprave përfaqësuese të prozës, poezisë dhe dramës moderne angleze.
4. Përdorin fjalor të specializuar letrar, të ndërtojnë recensione tematike dhe të shkruajnë me qartësi dhe saktësi në mënyrë akademike dhe krijuese.